

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË, Departamenti i përgjithshëm-Divizioni civil**, si gjykatë civile e shkallës së parë me gjyqtarin Binak Duqi dhe sekretaren juridike Valentina Rekalii, në çështjen juridike kontestimore të paditëses S. A. S. nga P., rr.”...” pnr., të cilën e përfaqëson i autorizuari i saj R. S. nga P., me autorizim, kundër të paditurit H. Rr. H. nga fshati O., Komuna e P., të cilin e përfaqëson i autorizuari i tij S. H. nga O., me autorizim, baza e kontestit për pengim posedimi, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik në praninë e paditëses, të autorizuarit të paditëses si dhe të paditurit dhe të autorizuarit të paditurit, më dt.22.10.2014 mori këtë:

### **A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** padia e paditëses S. A. S. nga P., rr.”...” pnr., kundër të paditurit H. Rr. H. nga fshati O., Komuna e P., për pengim posedimi, **SI E PA BAZUAR**, me të cilën ka kërkuar që të “Vërtetohet se i padituri H. Rr. H. nga fshati O., e ka penguar dhe trazuar paditësen në posedimin e lirë dhe faktik të palujtshmërisë së saj, e cila gjindet në fshatin O., ngastra kadastrale nr.215, e cila gjindet në vendin e quajtur “Seishtë”, në sipërfaqe prej 775 m<sup>2</sup>, të evidentuar në fletën poseduese nr.318 ZK O., ashtu që me dt.05.06.2014, rreth orës 11,00, i padituri e ka penguar paditësen dhe njëherit nuk e kanë lejuar paditësen, që ta shfrytëzoi këtë palujtshmëri.”, gjithashtu ka kërkuar që “ I urdhërohet të paditurit që menjëherë të ndërpresë aktin e pengimit në posedim dhe në të ardhmen mos ta pengojnë paditësin në posedim dhe shfrytëzimin e palujtshmërisë të cekur më lartë, të përmbahen nga çfarëdo akti i tillë apo i ngjashëm i pengimit në posedim në të ardhmen, të gjitha këto në afatin prej 8 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi nën kanosje të përmbarimit me dhunë” , si dhe të “Detyrohet i padituri t’ia kompensoi shpenzimet gjyqësore paditëses aq sa do t’i caktoj gjykata, pasi që aktvendimi të bëhet i plotfuqishëm nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë”.

**URDHËROHET** paditësja S. A. S. nga P., rr.”...” pnr., që të bëjë pagesën e taksës gjyqësore në shumë prej 40 €uro, për padi si dhe shumë prej 40€uro për aktvendim, gjithsej shumë prej **80€uro**.

### **A r s y e t i m**

Paditësja dhe i autorizuari i paditëses në padi, në seancë dhe në fjalën përfundimtare kanë deklaruar se i padituri më pengon që ta shfrytëzoi lirshëm pronën edhe atë çdo ditë, pronën e kemi blerë ne që 2 vite por e punon i padituri, i cili ka filluar ta thur me shtylla druri në mënyrë që paditësja mos të ketë mundësi ta shfrytëzoi palujtshmërinë e vet lirshëm. I padituri na ka penguar në formë të ndryshme duke kërcënuar se kush do ta punoj këtu do të ketë pasoja, për këtë kemi edhe dëshmitarë për të cilët i propozoi gjykatës që të dëgjohen.

Andaj i ka propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses ta aprovoi në tërësi si të bazuar.

Shpenzimet e procedurës i kërkoi.

I padituri dhe i autorizuari i tij në përgjigje në padi, duke u përgjigjur në thëniet e palës paditëse gjatë seancës dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e kontestoi në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses si të pa bazuar, sepse prona kontestuese është pronë e B. H., të cilën na e ka dhënë në shfrytëzim që nga viti 2000 dhe unë e punoj këtë tokë që 15 vite prej vitit 2000.

Prandaj i propozoi gjykatës që ta refuzoi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses si të pa bazuar.

Shpenzimet e procedurës i kërkoi.

Për të vërtetuar rrethanat gjykata sipas propozimit të paditësit i dëgjoi dëshmitarët Xh. H. e H. H. nga O. dhe I.S. nga P., gjithashtu u dëgjuan edhe dëshmitarët e propozuar nga i padituri I., H1., T. dhe F. H. të gjithë nga O..

Gjykata për të vërtetuar drejt gjendjen faktike në këtë çështje juridike civile në procedurën kontestimore bëri administrimin dhe leximin e këtyre provave: u lexua certifikata mbi të drejtat në palujtshmëri UL-71712057-00318 e dt.19.02.2013, kopja e palnit e Drejtorisë për Kadastër dhe Gjeodezi ZK Ob. e dt.19.02.2013 si dhe skica fotografia e parcelave, u lexuan autorizimet e palëve, u lexua certifikata tjetër P-71712057-00215-2 dt.29.07.2014 si dhe certifikata tjetër P-71712057-00215-1 dt.29.07.2014.

Meqenëse palët ndërgjygjëse nuk patën prova dhe propozime të reja duke propozuar dëshmitar, daljen në vend ngjarje të gjykatës, atëherë gjykata bëri vlerësimin e tyre një nga një e të gjithave së bashku konform nenit 8 të LPK-së, dhe vërtetoi se padia dhe kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar dhe si të tillë e refuzoi.

Nga dëshmitarët e dëgjuar të propozuar nga pala e paditur I., H1., T. dhe F. H., gjykata nga dëshmitë e tyre vërtetoi se posedimin në këtë palujtshmëri e ka i padituri që prej pas lufte e deri sot dhe nuk ka bërë për paditësin kurrfarë pengim posedimi siç pretendoi dhe kërkoi ai në kërkesëpadi, ngase paditësi nuk e ka pasur asnjëherë pushtetin faktik (posedimin) mbi palujtshmërinë, edhe atë ngastrën kadastrale nr.215-1, Certifikatën mbi të drejtën e pronës UL-71712057-00318, në sipërfaqe prej 775 m<sup>2</sup>, në vendin e quajtur “Senishtë” në fshatin O., Komuna e P..

Nga dëshmitarët e propozuar nga pala paditëse Xh. H., H.H. dhe I.S., nga dëshmitë e tyre vërtetohet se paditësi nuk ka qenë në posedim asnjëherë dhe se në një gjendje të tillë nuk ka mundur që të ketë kurrfarë pengim posedimi nga i padituri i cili sipas këtyre dëshmitarëve e punon dhe e posedon atë palujtshmëri nga pronari faktik sipas marrëveshjes së tyre. Andaj posedimin e mban i padituri H. H. siç deklaroi edhe vet paditësi, i padituri dhe dëshmitarët e propozuar nga pala e paditur por edhe nga dëshmitarët e propozuar nga pala paditëse. Në këtë kontest nuk është objekt shqyrtimi pronësia- se kush është pronar ligjor apo faktik, por fakti se kush e ka pushtetin faktik-posedimin mbi palujtshmërinë e këtë e ka në rastin konkret i padituri H. H. dhe këtu nuk kemi kurrfarë akti të pengim posedimit siç thuhet në nenin 78 të Ligjit mbi marrëdhëniet themelore juridike pronësore, i cili thekson se “ gjykata i siguron mbrojtjen sipas gjendjes së fundit të posedimit dhe pengimit të bërë, me ç’rast nuk ka ndikuar e drejta për

posedim, baza juridike e posedimit dhe mirëbesueshmëria e mbajtësit” mbaron citati, në rastin konkret gjendja e fundit si posedues kemi të paditurin H. H..

I padituri në këtë plujtshmëri e ka posedimin e sendit dhe e ushtron drejtpërdrejt zotërimin faktik të sendit (posedimin e drejtpërdrejtë), sipas nenit 70 të Ligjit mbi marrëdhëniet themelore juridike pronësore dhe nenit 103 të Ligjit për pronën dhe të drejtat sendore.

Duke pasur parasysh se procedura për pengim posedimi ka për qëllim vendosjen e gjendjes së fundit faktike të posedimit me padinë e paditësit nuk mund të kërkohet një gjë e tillë, sepse paditësi asnjëherë nuk ka pasur as nuk ka krijuar pushtet faktik-posedim mbi palujtshmërinë por këtë e ka i padituri siç e parasheh neni 104 i Ligjit për pronën dhe të drejtat sendore, andaj nuk mund të aprovohet kërkesëpadija e tij si e tillë, sepse nuk ka bazë në dispozitat e ligjit në fjalë LMTHPJ, për një gjë të tillë, sepse pengim posedimi ekziston kur kemi posedimin e personit mbi palujtshmërinë e në rastin kontestues nuk ka posedim nga paditësi, atëherë nuk ka pengim posedimi.

Provat tjera që gjenden në shkresat e lëndës siç janë Certifikatën mbi të drejtën në palujtshmëri dhe kopja e planit të lëshuara nga Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë e Komunës së P., nuk janë të rëndësishme së veçantë dhe të vlefshme në rastin e padisë për pengim posedimi, sepse këtu kërkohet vetëm kush ka posedimin mbi palujtshmërinë-gjendja e fundit, e këtë e ka i padituri prej pasluftës në vitin 2000 e deri me sot.

Në këtë rast paditësi më mirë do kishte qenë sikur me padi të kishte kërkuar të drejtat e tij për të cilat ai pretendon në pronën kontestuese.

Andaj, pas vlerësimit të tillë të gjendjes, deklarimi i palëve, dëshmia e dëshmitarëve, provat e administruara, gjykata gjeti se nuk kemi të bëjmë me pengimin e posedimit nga ana e të paditurit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës gjyqësore që secila palë t’i bart shpenzimet e veta u mor konform nenit 449, 450 dhe nenit 452.1 të LPK-së.

Nga sa u tha më lartë vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi konform nenit 478, 480, 481.2 të LPK-së, nenit 103, 104 të Ligjit mbi pronësinë dhe të drejtat tjera sendore dhe ish Ligji mbi marrëdhëniet pronësore juridike neni 70 dhe 70.1.

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË- DEGA PODUJEVË**  
**C.nr.331/2014 të dt.22.10.2014**

**Gjyqtari ,**  
Binak Duqi

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afatin prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj gjykate.